
DETYRË PROJEKTIMI

PËR REALIZIMIN E STUDIM – PROJEKTIMIT

ME OBJEKT:

"Sistemim – asfaltimi i rrugës së fshatit Pacomit"

Përmet, 20.05.2026

DETYRË PROJEKTIMI

Objekti :

"Sistemim – asfaltimi i rrugës së fshatit Pacomit"

Vendndodhja : Bashkia Përmet, Njësia Administrative Qendër – Piskovë

PËRMBAJTJA

1. Të dhëna të përgjithshme
2. Gjendja ekzistuese
3. Kërkesat e projektit
4. Fazat e hartimit të projektit
5. Standartet dhe normat e projektimit
6. Dorëzimi i dokumentacionit
7. Rekomandime për projektuesin
8. Përfundime dhe rekomandime tekniko-ekonomike

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

1.1 Objekti i projektit

Bashkia Përmet kërkon hartimin e projektit teknik me objekt:

"Sistemim – asfaltimi i rrugës së fshatit Pacomit", me vendndodhje në Njësinë Administrative Qendër – Piskovë, Bashkia Përmet.

Objekti i projektit konsiston kryesisht në sistemimin dhe asfaltimin e rrugës ekzistuese të fshatit Pacomit, e cila aktualisht është rrugë me taban natyral të përmirësuar me shtresa çakëlli të ngjeshur. Rruga shërben si lidhja kryesore e fshatit Pacomit me rrjetin rrugor të Njësisë Administrative Qendër – Piskovë dhe aksin nacional Përmet - Këlcyrë dhe mundëson aksesin e banorëve në shërbimet publike, arsimin, shëndetësinë dhe tregun. Për shkak të mungesës së shtresave asfaltike dhe dëmtimeve të akumuluara me kalimin e viteve, aksi rrugor është bërë vështirësisht i kalueshëm në kushte atmosferike të pafavorshme, duke krijuar vështirësi të konsiderueshme për banorët dhe përdoruesit e kësaj rruge.

Gjatësia e përafërt e rrugës : 2.205 km

Gjatësia e saktë totale e rrugës objekt ndërhyrjeje dhe parametrat e tjerë teknikë do të përcaktohen në bazë të rilevimit topografik që do të kryejë projektuesi, si pjesë e fazës së parë të hartimit të projektit.

1.2 Qëllimi i investimit

Qëllimi i investimit është përmirësimi i infrastrukturës rrugore ekzistuese, rritja e sigurisë së qarkullimit rrugor, përmirësimi i aksesit të banorëve dhe mjeteve, si dhe krijimi i kushteve më të mira për zhvillimin ekonomik, social dhe bujqësor të zonës.

Gjendja aktuale e rrugës paraqet problematika gjatë qarkullimit, veçanërisht në periudha reshjesh, si pasojë e amortizimit të shtresave ekzistuese, mungesës së asfaltimit dhe problematikave të kullimit dhe disiplinimit të ujërave sipërfaqësore. Kjo situatë ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetesës së banorëve të fshatit Pacomit, të cilët hasin vështirësi në lëvizjen e përditshme, transportin e mallrave bujqësore dhe aksesin në shërbimet bazë. Gjatë dimrit dhe periudhave të reshjeve të dendura, aksi rrugor bëhet praktikisht i pakalueshëm, duke izoluar banorët dhe duke shkaktuar dëme materiale.

Nëpërmjet këtij investimi synohet realizimi i një infrastrukture rrugore funksionale, të qëndrueshme dhe në përputhje të plotë me standartet teknike në fuqi. Investimi parashikohet të sjellë efekte pozitive dhe të qëndrueshme të drejtpërdrejta në cilësinë e jetesës së banorëve, në zhvillimin e aktiviteteve bujqësore dhe ekonomike të zonës, si dhe në lidhjen me zonat fqinje.

2. GJENDJA EKZISTUESE

Rruga e fshatit Pacomit është rrugë ekzistuese rurale, e përmirësuar me shtresa çakëlli të ngjeshur. Rruga kalon nëpër terren me karakteristika të ndryshme, me zona të sheshta dhe segmente me pjerrësi, duke ndjekur konfiguracionin natyror të relievit të zonës. Në segmente të ndryshme të saj konstatohet:

- mungesë e shtresave asfaltike përgjatë gjithë rrugës;
- amortizim i shtresave rrugore ekzistuese;
- deformime dhe dëmtime të trupit të rrugës;
- mungesë ose pamjaftueshmëri e sistemit të kullimit dhe disiplinimit të ujërave;
- gjerësi e ndryshueshme e karrexhatës;
- mungesë e elementëve të sigurisë rrugore dhe sinjalistikës rrugore.

Amortizimi i shtresave rrugore është rezultat i përdorimit të vazhdueshëm të rrugës pavarësisht ndërhyrjeve mirëmbajtëse gjatë viteve të fundit. Shtresat e çakëllit të ngjeshur janë konsumuar në masë të konsiderueshme, duke ekspozuar shtresat e poshtme ndaj veprimit të ujit dhe ngarkesave të trafikut. Kjo ka çuar në formimin e gropave, rrudhave dhe deformimeve të ndryshme të sipërfaqes rrugore, të cilat e bëjnë qarkullimin të vështirë dhe të pasigurt.

Sistemi i kullimit dhe disiplinimit të ujërave sipërfaqësore është i pamjaftueshëm ose mungon plotësisht në segmente të caktuara. Mungesa e kanaleve kulluese anësore dhe e veprave të tjera të kullimit bën që uji i reshjeve të qëndrojë mbi sipërfaqen e rrugës ose të depërtojë në

trupin e saj, duke shkaktuar destabilizim të shtresave rrugore dhe dëmtime të mëtejshme. Gjatë periudhave të reshjeve të dendura, ujërat sipërfaqësore rrjedhin të pakontrolluara mbi karrexhatë, duke shkaktuar gërryerje dhe largim të materialit rrugor.

Gjerësia e karrexhatës ndryshon përgjatë aksit rrugor, duke mos plotësuar kërkesat minimale teknike në disa segmente. Kjo bën të vështirë kalimin e njëkohshëm të dy mjeteve, sidomos të mjeteve bujqësore me dimensione të mëdha, duke krijuar situata të rrezikshme për qarkullimin. Mungesa e bankinave të rregullta dhe e elementëve të sigurisë rrugore rrit rrezikun e aksidenteve, veçanërisht në segmentet me pjerrësi dhe kthesa.

Sinjalistika rrugore horizontale dhe vertikale mungon plotësisht përgjatë aksit rrugor. Nuk ka asnjë tabelë orientuese, paralajmëruese apo kufizuese, dhe as vijëzime horizontale. Kjo situatë paraqet problematika të theksuara gjatë orëve të natës dhe në kushte vizualiteti të reduktuar.

Gjendja ekzistuese infrastrukturore e aksit rrugor ndikon negativisht në lëvizjen e mjeteve dhe këmbësorëve, sidomos gjatë kushteve atmosferike të pafavorshme. Banorët e fshatit Pacomit dhe operatorët ekonomikë të zonës kanë vënë në dukje vazhdimisht nevojën për ndërhyrje në këtë aks rrugor, duke e konsideruar rehabilitimin e tij si prioritet për komunitetin.

3. KËRKESAT E PROJEKTIT

Projektuesi do të hartojë projektin teknik të zbatimit për sistemim – asfaltimin e rrugës së fshatit Pacomit, duke respektuar kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit të rrugëve, standartet shqiptare dhe europiane në fuqi, si dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor. Projekti duhet të japë zgjidhje të plota teknike për të gjitha problematikat e konstatuara në gjendjen ekzistuese dhe të garantojë një infrastrukturë të qëndrueshme dhe funksionale për një periudhë afatgjatë.

Përgjegjësia profesionale:

Projektuesi mban përgjegjësi të plotë profesionale për saktësinë teknike të dokumentacionit dhe përputhshmërinë e tij me standartet dhe legjislacionin në fuqi. Kjo përgjegjësi vlen për të gjitha fazat dhe elementët e projektit të përshkruar më poshtë.

Përpara fillimit të hartimit të projektit, projektuesi do të kryejë të gjitha studimet dhe verifikimet e nevojshme në terren, të grumbullojë të dhënat ekzistuese dhe të analizojë kushtet reale të rrugës. Çdo zgjidhje teknike e propozuar do të jetë e argumentuar dhe e mbështetur në të dhënat e mbledhura gjatë fazës së studimit.

KERKESAT QE DUHET TE ZGJIDHE PROJEKTI:

1. Hoorografia ose Planvendosja, ne shkalle 1:5000.
2. Hartimi I relievit topografik (koordinata lokale,kuota absolute),shkalle 1:1000.
3. Përcaktimin e aksit me elementet gjeometrike 1:1000 ose 1:500.
4. Planimetrinë e rrugës në shkallë 1:1000 ose 1:500.
5. Profili gjatësor në shkallë 1:1000 ose 1:500.
6. Profilet terthore dhe Profilat TIP në shkallë 1:50 ose 1:100.
7. Planimetri dhe detaje për lëvizshmëri/sinjalistikë rrugore (vertikale dhe horizontale).
8. Planimetrinë për rrjetin e kanalizimeve te ujrave të bardha, si dhe detaje e prerje të kanaleve, tombinove etj.
9. Projekti dhe llogaritjet përkatëse mbi veprat e artit nëse ka.
10. Projekti elektrik i ndricimit rrugor me relacionin përkatës.
11. Detaje të ndryshme (bordura, trotuare, kanale, shtresa rrugore, tombino, mure pritëse dhe mbajtëse, barriera mbrojtëse sinjalistika etj).
12. Kryqëzimet dhe detaje përkatëse, si dhe vendndërimet e mjeteve.
13. Raporti teknik mbi zgjidhjen e dhënë.
14. Specifikimet teknike të zbatimit të projektit.
15. Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM).
16. Relacionet perkatese konstruktive,topografike,gjeologjike,hidrogeologjike, sizmologjike etj.
17. Grafiku i punimeve.
18. Preventivi i punimeve mbeshtetur ne çmimet e VKM nr. 216, date 13.4.2023, si dhe analizat teknike perkatese per zerat e paparashikuara ne kete VKM.
19. Të gjitha fletët e vizatimeve teknike duhet të jenë të detajuara me elementët përkatës, si dhe legjendat përkatëse.

3.1 Infrastruktura rrugore

Projektuesi do të parashikojë:

- rilevimin topografik të aksit rrugor;
- azhornimin e gjendjes ekzistuese;
- përcaktimin e gjurmës së rrugës dhe profileve tip;
- sistemimin e trupit të rrugës;
- realizimin e shtresave rrugore;
- asfaltimin e karrexhatës;
- sistemimin e bankinave;
- vendosjen e bordurave sipas nevojës;
- vendosjen e sinjalistikës rrugore horizontale dhe vertikale;
- elementët e sigurisë aktive dhe pasive rrugore;
- masat për aksesin dhe sigurinë gjatë fazës së zbatimit të punimeve;
- vendosjen e të gjitha veprave të artit të nevojshme për mirëfunksionimin e rrugës
- vendosjen e të gjitha barrierave mbrojtëse
- vendosjen e të gjitha elementeve konstruktivë për mosdëmtim të rrugës
- Etj..

Gjurma e rrugës do të përcaktohet në bazë të aksit ekzistues, duke parashikuar korrigjime të nevojshme në segmentet me problematika të theksuara gjeometrike. Profili gjatësor dhe profilet tërthore do të hartohen duke marrë në konsideratë kushtet e terrenit, kërkesat e kullimit dhe standartet minimale teknike për rrugët rurale. Gjerësia e karrexhatës do të përcaktohet në përputhje me klasifikimin teknik të rrugës dhe volumn e trafikut, për të garantuar kalimin e sigurt të mjeteve në të dyja drejtimet, ose përcaktimin e vendshkëmbimeve të automjeteve.

Shtresat rrugore do të projektohen për të garantuar qëndrueshmëri dhe rezistencë ndaj ngarkesave të trafikut. Struktura e shtresave do të përcaktohet në bazë të studimit gjeologjik dhe hidrologjik të zonës, karakteristikave të nënshtresës dhe ngarkesave të parashikuara. Projektuesi do të parashikojë materialet e nevojshme dhe specifikimet teknike për çdo shtresë.

3.2 Kullimi i ujërave

Në projekt do të parashikohet sistemi i largimit të ujërave sipërfaqësore, duke përfshirë:

- kanale kulluese anësore;
- tombino;
- puseta;
- vepra arti të vogla sipas nevojës;
- masa mbrojtëse për stabilitetin e trupit të rrugës;
- Etj..

Projektuesi do të analizojë kushtet hidrologjike të zonës dhe do të japë zgjidhje teknike të argumentuara për largimin e ujërave. Analiza hidrologjike do të mbulojë të gjithë basenin ujëmbledhës që ndikon mbi aksin rrugor, duke llogaritur prurjet e projektit për periudhat e kthimit të parashikuara nga standartet. Në bazë të kësaj analize, projektuesi do të dimensionojë saktë të gjithë elementët e sistemit të kullimit.

Kanalet kulluese anësore do të projektohen për të mbledhur dhe larguar ujërat sipërfaqësore nga karrexhata dhe bankinat, duke i drejtuar drejt kanaleve natyrorë ose strukturave të kullimit. Tombinot dhe pusetat do të vendosen në pikat e grumbullimit të ujërave dhe në vendet ku ka kryqëzim me rrjetin hidrologjik ekzistues. Projektuesi do të parashikojë masa mbrojtëse për stabilitetin e trupit të rrugës në segmentet me rrezik të lartë gërryerjeje ose rrëshqitjeje.

3.3 Siguria dhe sinjalistika rrugore

Projekti do të përfshijë sinjalistikën horizontale dhe vertikale sipas Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe rregulloreve përkatëse. Duhet të parashikohen:

- tabela orientuese dhe paralajmëruese;
- vijëzimet horizontale;
- elementët e sigurisë aktive dhe pasive rrugore;
- masat për sigurinë e këmbësorëve dhe mjeteve gjatë qarkullimit.

Projektuesi do të trajtojë të gjithë elementët e sigurisë aktive dhe pasive, duke marrë në konsideratë shikueshmërinë, kthesat, pjerrësitë dhe karakteristikat e terrenit. Vendosja e sinjalistikës do të bëhet në përputhje të plotë me kërkesat e Kodit Rrugor dhe do të mbulojë të gjitha pikat kritike. Vijëzimet horizontale do të realizohen me materiale reflektuese të cilësisë së lartë.

Projektuesi do të identifikojë segmentet me pjerrësi të lartë dhe kthesat e rrezikshme, duke propozuar masa specifike për rritjen e sigurisë, si vendosja e barrierave mbrojtëse, zgjerimi i karrexhatës në pikat kritike dhe instalimi i sinjalistikës paralajmëruese. Të gjitha masat do të projektohen duke marrë në konsideratë mjetet motorike, këmbësorët dhe mjetet bujqësore.

3.4 Studimet dhe verifikimet

Përpara fillimit të projektimit, projektuesi duhet:

- a) të kryejë rilevimin topografik të aksit rrugor;
- b) të realizojë verifikimet në terren për gjendjen ekzistuese;
- c) të realizojë studimet gjeologjike, hidrologjike dhe gjeoteknike sipas nevojës;
- d) të verifikojë kushtet e stabilitetit të trupit të rrugës dhe zonave problematike;
- e) të evidentojë ndërhyrjet e nevojshme për mbrojtjen e rrugës.
- f) të realizojë studimet për sa i përket ndikimit në mjedis që do të kenë punimet për sistemimin e rrugës.

Rilevimi topografik do të kryhet me mjete dhe metoda të përshtatshme, duke siguruar saktësinë e nevojshme. Të dhënat topografike do të përpunohen dhe paraqiten në formatin e kërkuar, duke përfshirë planimetrinë, profilet gjatësore dhe tërthore. Studimet gjeologjike do të përfshijnë karakterizimin e nënshtresës dhe vlerësimin e aftësisë mbajtëse, ndërsa studimet hidrologjike do të analizojnë regjimin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Të gjitha studimet do të dokumentohen plotësisht në dosjen e projektit.

3.5 Veprat e artit

Në projekt do të parashikohen veprat e artit të nevojshme përgjatë aksit rrugor, në përputhje me kushtet e terrenit dhe kërkesat teknike. Projektuesi do të identifikojë të gjitha pikat ku është e nevojshme ndërtimi ose rehabilitimi i veprave të artit, duke përfshirë:

- ura mbi rrjedhjet ujore nëse është e nevojshme;
- tombino kalimi për ujërat sipërfaqësore;
- vepra arti për kalimin e kanaleve ekzistuese të ujitjes ose kullimit;
- vepra të tjera arti sipas nevojës së terrenit.

Projektuesi do të kryejë inspektimin e plotë të aksit rrugor për të evidentuar të gjitha pikat ku prania e rrjedhjeve ujore, kanaleve apo strukturave ekzistuese kërkon ndërtimin e veprave të artit. Çdo vepër arti do të projektohet në përputhje me standartet teknike, për të garantuar kapacitetin e nevojshëm hidraulik dhe qëndrueshmërinë strukturore. Dimensionimi do të mbështetet në analizën hidrologjike dhe do të marrë në konsideratë prurjet maksimale për periudhën e kthimit të kërkuar. Dokumentacioni i veprave të artit do të përfshijë vizatimet konstruktive, llogaritjet statike dhe specifikimet teknike të materialeve.

3.6 Muret mbajtëse

Në segmentet ku konfigurimi i terrenit dhe kushtet e stabilitetit e kërkojnë, projektuesi do të parashikojë ndërtimin e mureve mbajtëse. Muri mbajtës është element thelbësor për garantimin e stabilitetit të trupit të rrugës në zonat me pjerrësi të lartë, terrene të brishta ose ku gjerësia e nevojshme e platformës rrugore nuk mund të arrihet pa ndërhyrje strukturore.

Projektuesi, nëse ka, do të identifikojë të gjitha segmentet që kërkojnë mure mbajtëse dhe do të propozojë zgjidhjen më të përshtatshme teknike dhe ekonomike për secilin rast, duke përfshirë:

- mure mbajtëse prej betoni të armuar;
- mure mbajtëse prej gurësh të lidhur me llaç;
- gabione dhe struktura të tjera mbajtëse sipas nevojës.

Llogaritjet statike dhe dimensionimi i mureve mbajtëse do të kryhen në përputhje me standartet teknike, duke marrë në konsideratë ngarkesën e rrugës, shtytjen e tokës, veprimin e ujërave nëntokësore dhe efektet sizmike. Projektuesi do të parashikojë gjithashtu sistemin e drenimit pas mureve mbajtëse, për të shmangur akumulimin e presionit hidrostatik. Të gjitha muret mbajtëse do të dokumentohen me vizatime konstruktive të detajuara dhe llogaritje të plota statike.

3.7 Përforsimi i skarpatave

Nëse ka, në segmentet ku skarpatat e prerjes ose të mbushjes paraqesin rrezik rrëshqitjeje, gërryerjeje ose destabilizimi, projektuesi do të parashikojë masat e nevojshme për përforsimin dhe mbrojtjen e tyre. Stabiliteti i skarpatave përbën një kusht themelor për sigurinë e aksit rrugor.

Projektuesi do të evidentojë të gjitha zonat me skarpa të paqëndrueshme dhe do të propozojë zgjidhjet teknike më të përshtatshme, duke përfshirë:

- mbjelljet mbrojtëse me bimësi të përshtatshme për konsolidimin e skarpatave;
- rrjetat mbrojtëse metalike në zonat me rrezik gurësh të lirshëm;
- ankorimin dhe forcimin e skarpatave me teknika të injektimit etj.;
- drenazhimin e skarpatave për uljen e presionit të ujërave nëntokësore;
- mbrojtjen me gurë ose beton të projektuar në zonat me gërryerje të theksuar;
- masa të tjera stabilizimi sipas karakteristikave specifike të terrenit.

Projektuesi do të kryejë analizën e stabilitetit të skarpatave në bazë të të dhënave gjeologjike dhe gjeoteknike, duke identifikuar mekanizmat e mundshëm të dështimit dhe duke propozuar masa mbrojtëse të dimensionuara saktë. Zgjidhjet e propozuara do të jenë funksionale, ekonomike dhe të integruara me mjedisin natyror. Dokumentacioni teknik do të përfshijë llogaritjet e stabilitetit, vizatimet e detajuara dhe specifikimet teknike.

4. FAZAT E HARTIMIT TË PROJEKTIT

Hartimi i projektit teknik do të realizohet në përputhje të plotë me fazat e përcaktuara nga V.K.M Nr.354, datë 11.05.2016. Çdo fazë përbën një hap të domosdoshëm dhe do të përfundojë para se të fillojë faza pasardhëse. Projektuesi është përgjegjës për cilësinë dhe saktësinë e dokumentacionit të çdo faze dhe do të konsultohet me Autoritetin Kontraktor në çdo hap.

Faza I – Analiza e detyrës së projektimit / Termat e referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit

Në këtë fazë projektuesi realizon analizën e plotë të detyrës dhe përcakton bazën teknike.

Përfshin:

- analizën e detyrës së projektimit dhe të termave të referencës;
- grumbullimin dhe studimin e të dhënave ekzistuese për aksin rrugor;
- verifikimet në terren dhe dokumentimin fotografik;
- rilevimin paraprak të aksit rrugor;
- evidentimin dhe katalogimin e problematikave;
- identifikimin e zonave me rrezik të lartë;
- përcaktimin e parametrave bazë të projektit;
- hartimin e raportit paraprak mbi gjendjen ekzistuese dhe nevojat e ndërhyrjes.

Në fund të fazës, projektuesi paraqet raportin e analizës pranë Autoritetit Kontraktor.

Faza II – Projekt-ideja paraprake

Projektuesi paraqet zgjidhjen paraprake teknike, duke propozuar alternativa dhe duke argumentuar zgjidhjen e rekomanduar.

Përfshin:

- planimetrinë e përgjithshme të aksit rrugor me zgjidhjen e propozuar;
- profilet tip të karrexhatës dhe elementëve kryesorë;
- zgjidhjen paraprake të sistemit të kullimit;
- identifikimin paraprak të veprave të artit, mureve mbajtëse dhe masave të përforcimit;
- relacionin teknik me argumentimin e zgjidhjes;
- analizën krahasuese të alternativave;
- preventivin paraprak të punimeve.

- Faza III – Projekt-ideja përfundimtare

Në bazë të zgjidhjes së miratuar, projektuesi përpunon projekt idenë përfundimtare.

Përfshin:

- planimetrinë e detajuar të aksit rrugor;
- profilet gjatësore dhe tërthore të konsoliduara;
- zgjidhjen përfundimtare të sistemit të kullimit;
- projektin paraprak të veprave të artit dhe mureve mbajtëse;
- masat e përforcimit të skarpave të konsoliduara;
- relacionet teknike të detajuara për çdo kategori (arkitektonik, konstruktiv, topografik, elektrik, gjeodezik, hidrologjik, sizmologjik, mjedisor etj);
- planin për vendsojen e sinjalistikës rrugore vertikale dhe horizontale
- projektin për rrjetin elektrik të ndricimit rrugor
- preventivin e konsoliduar të punimeve.

-

Faza IV – Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit, si dhe dokumentacionin e plotë të nevojshëm për marrjen e çdo lloj leje apo miratimi institucional të nevojshëm.

Projektuesi harton dokumentacionin e plotë teknik për procedurën e marrjes së lejes së ndërtimit, kryerjen e oponencës teknike, si dhe dokumentacionin e plotë të nevojshëm për marrjen e çdo lloj leje apo miratimi institucional të nevojshëm.

Përfshin:

- dokumentacionin teknik sipas kërkesave të autoriteteve kompetente;
- relacionin teknik të projektit;
- planimetritë dhe vizatimet teknike të nevojshme;
- studimin gjeologjik, sizmologjik dhe hidrologjik të finalizuar;
- dokumentacionin mjedisor sipas nevojës;
- çdo dokumentacion tjetër të kërkuar.

- Faza V – Projekti i zbatimit

Projekti i zbatimit përbën dokumentin teknik kryesor për realizimin e punimeve në terren.

Dosja e projektit të zbatimit përmban:

- raportet teknike dhe relacionet përshkruese (arkitektonik, konstruktiv, topografik, elektrik, gjeodezik, hidrologjik, sizmologjik, mjedisor etj);
- rilevimin topografik të finalizuar;
- studimin gjeologjik, hidrologjik dhe sizmologjik;
- planimetrinë e sistemit të rrugës;
- profilin gjatësor të aksit rrugor;
- profilet tërthore në intervalet e kërkuara dhe të nevojshme;
- profilet tip të karrexhatës dhe elementëve të tjerë;
- detajet konstruktive të të gjitha elementëve;
- projektin e kullimit dhe disiplinimit të ujërave me dimensionimet përkatëse;
- projektin e veprave të artit me llogaritjet statike;
- projektin e mureve mbajtëse me llogaritjet statike;
- projektin e përforcimit të skarpatave;
- sinjalistikën horizontale dhe vertikale;
- projektin elektrik të ndricimit rrugor;
- vlerësimin e ndikimit në mjedis;
- specifikimet teknike të materialeve dhe punimeve;
- volumet e punimeve;
- planin e organizimit të kantierit;
- grafikun e punimeve;
- planin e menaxhimit mjedisor gjatë zbatimit;
- çdo dokument tjetër të nevojshëm konform legjislacionit në fuqi.

Faza VI – Preventivi përfundimtar

Projektuesi harton preventivin përfundimtar të punimeve, i cili është i detajuar, i saktë dhe pasqyron plotësisht volumet dhe kostot.

Preventivi përmban:

- listën e plotë të punimeve sipas kategorive;
- volumet e sakta të çdo zëri punimesh;
- analizat teknike të çmimeve për çdo zë që nuk përfshihet në manualin e çmimeve;
- çmimet e njësisë për materialet, punën dhe mjetet;
- koston totale të investimit të ndarë sipas kategorive;
- fondin rezervë për punimet të paparashikuara;
- pajisjet dhe makineritë e nevojshme që mund të nevojiten të vendosen në vepër;

Analizat teknike të çmimeve hartohen në përputhje me manualet dhe normat teknike në fuqi.

Hartimi i preventivit dhe analizave të çmimeve do të bëhet konform V.K.M Nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim"

Faza VII – Përgatitja e dokumentacionit për procedurë tenderimi

Projektuesi përgatit të gjithë dokumentacionin teknik të nevojshëm për zhvillimin e procedurës së tenderimit.

Përfshin:

- specifikimet teknike të detajuara për zbatimin e punimeve;
- çdo dokumentacion tjetër teknik të nevojshëm sipas legjislacionit për prokurimet publike.

5. STANDARTET DHE NORMAT E PROJEKTIMIT

Projektimi do të realizohet në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe standartet teknike kombëtare dhe europiane. Projektuesi është përgjegjës për njohjen dhe zbatimin e të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore, standarteve dhe normave teknike që rregullojnë projektimin dhe zbatimin e veprave rrugore dhe të infrastrukturës publike.

5.1 Legjislacioni kryesor

- Ligji Nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij;
- Ligji Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" dhe aktet nënligjore përkatëse;
- V.K.M Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit";
- V.K.M Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit";
- V.K.M Nr. 354, datë 11.5.2016 "Për miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim";
- V.K.M Nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim"
- Aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

5.2 Kushtet teknike të projektimit të rrugëve

- Kushtet Teknike të Projektimit dhe Zbatimit të Rrugëve të miratuara nga autoritetet kompetente shqiptare;
- normat teknike për klasifikimin dhe parametrat gjeometrikë të rrugëve rurale;
- kërkesat teknike për strukturën e shtresave rrugore dhe materialet e përdorura;
- normat për sistemimin e bankinave, skarpatave dhe elementëve të tjerë të platformës rrugore;
- kërkesat teknike për projektimin e kthesave, pjerrësive gjatësore dhe tërthore;
- normat për distancat e dukshmërisë dhe elementët e gjeometrisë rrugore.

5.3 Standartet për veprat e artit dhe konstruksionet

- standartet dhe normat shqiptare të projektimit SSH EN etj.
- Eurokodet e aplikueshme (EC1, EC2, EC7, EC8);
- standartet shqiptare për materialet e ndërtimit dhe konstruksionet;
- normat teknike për projektimin sizmik (zona sizmike e Bashkisë Përmet);
- kërkesat teknike për projektimin e urave dhe veprave të artit rrugore;
- normat për projektimin e mureve mbajtëse dhe strukturave të mbajtjes së tokës;
- standartet për materialet e betonit, çelikut dhe gurëve.

5.4 Standartet hidrologjike, sizmologjike dhe gjeoteknike

- normat teknike shqiptare dhe europiane për studimet hidrologjike dhe hidraulike;
- standartet për karakterizimin gjeologjik dhe gjeoteknik të terrenit;
- normat teknike dhe standartet për studimin sizmologjik të terrenit ;
- Eurokodi 7 për projektimin gjeoteknik;
- normat për analizën e stabilitetit të skarpatave dhe konstruksioneve të mbajtjes së tokës;
- kërkesat teknike për sistemet e kullimit dhe disiplinimit të ujërave;
- metodologjitë e pranura për llogaritjen e prurjeve të projektit.

5.5 Standartet e sigurisë rrugore dhe sinjalistikës

- Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë dhe rregulloret përkatëse;
- normat teknike për sinjalistikën horizontale dhe vertikale;
- standartet për materialet reflektuese;
- kërkesat teknike për elementët e sigurisë aktive dhe pasive (barriera mbrojtëse, bordurat);
- normat për dukshmërinë.

5.6 Standartet e ndriçimit rrugor

- standartet dhe normat shqiptare të projektimit SSH EN etj.
- Eurokodet e aplikueshme (EC1, EC2, EC7, EC8);
- standartet shqiptare për materialet e ndriçimit dhe rrjetin furnizues;
- normat teknike për projektimin e rrjeteve të ndricimit rrugor ;
- normat dhe standartet për elementet vertikale (shtyllat) e ndricimit rrugor ;
- normat teknike për fluksin e ndricimit rrugor ;
- standartet për ndricuesit rrugorë;

5.7 Standartet mjedisore

- Ligji Nr. 10 440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" dhe aktet nënligjore;
- normat për mbrojtjen e mjedisit gjatë fazës së zbatimit;
- kërkesat për menaxhimin e materialeve të gërmimit dhe mbetjeve të ndërtimit;
- masat për mbrojtjen e rrjedhjeve ujore dhe ekosistemeve natyrore;
- kërkesat për rigjellbërimin dhe rivendosjen e mjedisit natyror.

6. DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT

Projektuesi do të dorëzojë dokumentacionin teknik të plotë pranë Autoritetit Kontraktor në përputhje me kërkesat e kësaj detyre dhe legjislacionin në fuqi. Dokumentacioni dorëzohet në format fizik dhe elektronik. Çdo fazë dorëzohet për shqyrtim dhe miratim përpara fillimit të fazës pasardhëse.

6.1 Formati i dorëzimit

Format fizik: Dokumentacioni i printuar dhe i lidhur në dosje të veçanta për çdo fazë. Numri i kopjeve përcaktohet

nga Autoriteti Kontraktor. Vizatimet teknike printohen në formatin standart të nevojshëm. Çdo faqe përmban të dhënat e projektuesit, licencën, titullin e projektit, shënimet dhe sqarimet përkatëse, numrin e faqes, datën etj.. Çdo fletë do të jetë e nënshkruar dhe vulosur nga projektuesi përkatës.

Format elektronik: Në CD dhe USB. Dokumentet që përmbajnë tekst duhet të jenë në format të editueshëm (ëord, excel) edhe në PDF. Vizatimet duhet të dorëzohen në DËG/DXF dhe në format PDF. Skedarët organizohen në dosje sipas fazave.

6.2 Përmbajtja e dokumentacionit

Dokumentacioni i plotë përfshin të gjitha fazat e projektimit sipas legjislacionit në fuqi, si dhe:

- vizatimet teknike të plota dhe të detajuara;
- relacionet dhe raportet teknike për çdo projekt;
- studimet topografike, gjeologjike, sizmologjike dhe hidrologjike;
- llogaritjet statike dhe të qëndrueshmërisë;
- analizat e stabilitetit të skarpatave;
- preventivin përfundimtar dhe analizat teknike të çmimeve;
- specifikimet teknike;
- grafikun e punimeve, volumin e punimeve;
- planin e organizimit të kantierit dhe planin e menaxhimit mjedisor;
- dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e miratimeve të nevojshme institucionale.

6.3 Nënshkrimi dhe vulosja

Të gjitha dokumentet firmosen dhe vulosen nga projektuesit përgjegjës sipas legjislacionit. Çdo dokument teknik mban nënshkrimin dhe vulën e inxhinierit projektues përgjegjës, të licencuar. Vizatimet teknike mbajnë nënshkrimin e projektuesit dhe të kontrollorit teknik kur kërkohet.

6.4 Afatet e dorëzimit

Afatet përcaktohen në kontratën e shërbimit. Projektuesi respekton rreptësisht afatet. Autoriteti Kontraktor shqyrton dokumentacionin dhe jep vërejtjet brenda afateve kontraktuale. Projektuesi kryen korrigjimet dhe ridorëzon deri në miratimin përfundimtar.

6.5 Arkivimi

Projektuesi ruan kopje të plotë të të gjithë dokumentacionit. Ai vë në dispozicion dokumentet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor ose autoriteteve të tjera sa herë të jetë e nevojshme.

7. REKOMANDIME PËR PROJEKTUESIN

7.1 Konsultimi me Autoritetin Kontraktor

Projektuesi do të konsultohet vazhdimisht me Autoritetin Kontraktor. Komunikimi i rregullt dhe transparent është kusht themelor për suksesin e projektit. Projektuesi njofton Autoritetin Kontraktor për çdo problematikë të re, zgjidhje alternative dhe rrethana që ndikojnë në afate ose kosto. Organizohen takime periodike në pikat kyçe: pas studimeve në terren, pas zgjidhjes paraprake dhe para finalizimit të çdo faze.

7.2 Kushtet reale të terrenit

Projektuesi merr në konsideratë kushtet reale të terrenit në çdo vendim teknik. Zgjidhjet mbështeten në të dhënat e mbledhura drejtpërdrejt në terren. Vëmendje e veçantë i kushtohet natyrës gjeologjike të nënshtresës, ujërave nëntokësore, relievit dhe dukurive natyrore (rrëshqitje, gërryerje, vërshime).

7.3 Zgjidhje teknike funksionale dhe ekonomike

Projektuesi propozon zgjidhje funksionale, ekonomike dhe të qëndrueshme. Optimizimi i kostos nuk bëhet të bëhet në dëm të cilësisë. Analizohen alternativat dhe rekomandohet zgjidhja me raportin më të mirë cilësi/kosto, duke marrë parasysh disponueshmërinë e materialeve dhe kapacitetin e tregut vendas.

7.4 Minimizimi i ndikimeve gjatë zbatimit

Projektuesi minimizon ndikimet negative gjatë zbatimit. Plani i organizimit të kantierit dhe grafiku i punimeve garantojnë aksesin minimal të banorëve. Parashikohen masa për devijimin e trafikut gjatë fazave kritike. Mbrohen pronat private dhe infrastrukturat ekzistuese (ujësjellës, kablllo elektrike, telekomunikacion). Ndikimet mjedisore minimizohen përmes planit të menaxhimit mjedisor.

7.5 Qëndrueshmëria dhe funksionaliteti afatgjatë

Projektuesi garanton qëndrueshmëri dhe funksionalitet afatgjatë, me mirëmbajtje minimale. Jetëgjatësia e projektit përputhet me standartet. Parashikohen zgjidhje që marrin në konsideratë ndryshimet klimatike dhe rritjen e intensitetit të reshjeve. Materiale të cilësisë së lartë dhe të certikuara. Lehtësohet mirëmbajtja e ardhshme për të minimizuar kostot operative.

7.6 Koordinimi me institucionet dhe palët e interesuara

Projektuesi koordinohet me të gjitha institucionet dhe palët e interesuara: njësia administrative për nevojat e komunitetit, operatorët e rrjeteve për shmangien e konflikteve, autoritetet mjedisore kur kërkohet etj.. Nëse ka, evidentohen konfliktet me pronat private dhe infrastrukturat ekzistuese dhe i paraqiten Autoritetit Kontraktor në fazat e hershme.

8. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME TEKNIKO-EKONOMIKE

8.1 Përfundime të përgjithshme

Kjo detyrë projektimi hartohet për realizimin e projektit teknik me objekt "Sistemim – asfaltimi i rrugës së fshatit Pacomit", me qëllim përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe rritjen e cilësisë së jetesës së banorëve të zonës.

Rruga e fshatit Pacomit përbën një element të rëndësishëm të rrjetit rrugor rural të Njesisë Administrative Qendër – Piskovë dhe rehabilitimi i saj është prioritet i Bashkisë Përmet. Gjendja e vështirë ka ndikuar negativisht në lëvizjen e banorëve, zhvillimin e aktiviteteve bujqësore dhe aksesin në shërbime. Nëpërmjet këtij investimi, Bashkia Përmet synon të krijojë kushte për zhvillim të qëndrueshëm.

Projekti teknik do të japë zgjidhje të plota për të gjitha problematikat: sistemim dhe asfaltim të karrexhatës, zgjidhje të kullimit, vepra arti, sinjalistikë dhe siguri rrugore dhe nëse do të jetë e nevojshme edhe mure mbajtëse, përforcim skarpate etj.. Projekti do të realizohet në përputhje me standartet kombëtare dhe europiane.

Projektuesi duhet të angazhohet me profesionalizëm të lartë, të zbatojë me rigorozitet standartet dhe të japë zgjidhjet më të mira për çdo problematikë. Bashkia Përmet shpreh gatishmërinë për bashkëpunim të ngushtë, duke vënë në dispozicion informacionin dhe dokumentacionin ekzistues dhe duke mbështetur konsultimin me institucionet.

Realizimi i investimit do të sjellë efekte pozitive të qëndrueshme për komunitetin, duke përmirësuar kushtet e lëvizjes, nxitur zhvillimin ekonomik dhe bujqësor dhe rritur cilësinë e jetesës.

8.2 Konkluzione tekniko-ekonomike

Në përfundim të hartimit të kësaj detyre projektimi, vlerësohet se ndërhyrja e propozuar për sistemimin dhe asfaltimin e aksit rrugor të fshatit Pacomit përbën një investim strategjik për zhvillimin afatgjatë të zonës dhe përmirësimin e standarteve infrastrukturore të komunitetit lokal.


Realizimi i projektit teknik pritet të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e aksesit, rritjen e sigurisë së qarkullimit dhe lehtësimin e lëvizjes së mjeteve dhe banorëve gjatë gjithë vitit, duke reduktuar ndjeshëm problematikat aktuale të degradimit të aksit rrugor.

Në aspektin ekonomik, investimi do të kontribuojë në përmirësimin e transportit të produkteve bujqësore dhe rritjen e potencialit ekonomik të zonës, duke krijuar kushte më të favorshme për zhvillimin e aktiviteteve prodhuese dhe tregtare.

8.3 Rekomandimet kryesore

1. Projektuesi ti kushtojë rëndësi të veçantë projektimit të sistemit të kullimit dhe disiplinimit të ujërave sipërfaqësore, duke qenë se problematikat hidrologjike përbëjnë një nga faktorët kryesorë të dëmtimit të infrastrukturës rrugore në terrene rurale dhe kodrinore.
2. Të përdoren materiale të certifikuara dhe zgjidhje bashkëkohore të projektimit dhe zbatimit, për të garantuar jetëgjatësinë e investimit, minimizuar kostot e mirëmbajtjes dhe rritur performancën e përgjithshme të infrastrukturës rrugore.
3. Autoriteti Kontraktor dhe subjektet përgjegjëse për zbatimin e investimit të garantojnë kontroll të vazhdueshëm teknik dhe cilësor gjatë gjithë procesit të realizimit të punimeve, me qëllim respektimin e standarteve teknike, afateve kontraktuale dhe parametrave të miratuar në projekt.
4. Të konsultohet rregullisht komuniteti lokal për të adresuar nevojat specifike gjatë fazës së projektimit dhe zbatimit.

9. GJURMA E RRUGËS NË FRAGMENTIN E HARTËS SATELITORE



Hartoi : Ing.Laert Bushi

Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Miratoi :
KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA

